"Predha e armës shpoi derën e mjetit ku transportohej drogë", AMP jep detaje për sekuestrimin e 1 kg kokainë në Tiranë

22 Mars, 2024 14:01

Madhësia e tekstit:

Policia në Tiranë ka kryer një operacion antidrogë, teksa u kap 1 kilogram kokainë dhe në pranga kanë përfunduar shtetasit Enea Sulejmani, Igli Begaj 20 vjeç dhe Shkëlqim Ostreni 26 vjeç.

AMP me anë të një deklarate për mediat, ka dhënë detaje nga operacioni. Bëhet me dije se mes të arrestuarve dhe policisë ka pasur një përplasje. Për shkak të rezistencës ndaj policisë, efektivët kanë përdorur armë zjarri. Plumbat kanë shpuar derën e makinës ku transportohej droga, ku i plagosur ka mbetur shtetasi Enea Sulejmani.

Njoftimi:

Në datë 21.03.2024, në Rrugën "Mihal Duri' Tiranë, strukturat për Hetimin kundër Narkotikëve pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, gjatë veprimeve policore në funksion të një procedimi penal, me qëllim arrestimin e disa personave të dyshuar për veprën penale "Prodhim dhe shitje narkotikësh", e kryer në bashkëpunim, kanë hasur në kundërshtimin dhe mosbindjen e disa shtetasve, ku njëri prej tyre, duke drejtuar automjetin tip "Tiguan", në tentativë për t'u larguar, ka kryer manovra të rrezikshme duke goditur dhe duke u bërë rrezik serioz për jetën e disa punonjësve të policisë, si dhe ka shkaktuar dëme materiale një automjeti të Policisë së Shtetit.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, po kryen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore procedurale përfshirë këqyrjen dhe analizimin e pamjeve filmike të vendit të ngjarjes, me qëllim evidentimin dhe verifikimin e proporcionalitetit të veprimeve policore, nëse ato kanë qenë në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme.

Nga hetimet e deritanishme rezulton se gjatë kryerjes së veprimeve policore, me qëllim arrestimin e personave të dyshuar, punonjësit e Policisë u kanë bërë disa herë thirrje personave të dyshuar të ndalonin tentativat për t'u larguar dhe në kushtet kur drejtuesi i mjetit nuk është bindur, duke kryer manovra me rrezikshmëri të lartë për jetën e punonjësve të Policisë, është përdorur armë zjarri për neutralizmin e mjetit.

Për shkak të veprimeve intensive të punonjësve të Policisë si dhe lëvizjeve të çrregullta të automjetit, predha e armës, ka shpuar pjesën e derës së drejtuesit të automjetit, dhe si rezultat është plagosur shtetasi E.S., i cili ndodhet nën kujdesin e mjekëve në Spitalin e Traumës, jashtë rrezikut për jetën.

Sponsored Links

Lidhur me ngjarjen, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka arrestuar në flagrancë tre shtetas, me iniciale E.S., SH.O., I.B., si edhe u shpall në kerkim shtetasi M. H., si të dyshuar për veprat penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike", "Kundërshtim i punonjësit të policisë" dhe "Mosbindja ndaj punonjësve të policisë".

Vijojnë hetimet për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

(Balkanweb)

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: enea sulejmani

TË NGJASHME

Aksident me vdekje në Shënavlash-Sektor Rina, humb jetën 20-vjeçari
22 Mars, 2024

Dhunuan të riun me shkopinj dhe levë heku!, agresorët ishin zënë pak ditë më parë me 'shënjestrën'. Detajet
22 Mars, 2024

Taboola Feed

Arrestohet ish-pronari i Universitetit Kristal, ja për çfarë akuzohet
balkanweb.com

45 minuta pas fotos, dy prej këtyre të rinjve gjetën vdekjen
balkanweb.com

VIDEO trondítëse në Korçë/ Katër të rinj rrahin barbarisht me shkopinj 30-vjeçarin në servisin e automjetève. Policia...
balkanweb.com

"Nuk kam parë kurrë në jetë", qengji i porsalindur trondit fermerin
balkanweb.com

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Ngjarja në Korçë, Balla: Alarme që duhet ta mbajnë Policinë të vëmendshme ndaj këtyre fenomeneve
22 Mars, 2024

VIDEO trondítëse në Korçë/ Katër të rinj rrahin barbarisht me shkopinj 30-vjeçarin në servisin e automjetève. Policia identifikon autorët
22 Mars, 2024

Drejtonte mjetin luksoz pa targa dhe nuk i bindet policisë, ndëshkohet 28-vjeçari në Fier
22 Mars, 2024

Vetting: Si i ndau Belinda Balluku kontratat e "Fotovoltazhve"! Ná skenë del edhe Spartak Kovaçi i njëjëdëllait nën hetim nga SPAK
22 Mars, 2024

Balluku fshehu dokumentet/ Auditi i KLSH ngre pikëpyetje për procedurat e Parqeve Fotovoltaike dhe Eolike! Ministrja e Infrastrukturës merret nën hetim nga SPAK
22 Mars, 2024

Vrasja e 27-vjeçarit shqiptar në Londër, arrestohet autori (emrat)
22 Mars, 2024

KATEGORIA VIDEO

VIDEO trondítëse në Korçë/ Katër të rinj rrahin barbarisht me shkopinj 30-vjeçarin në servisin e automjetève. Policia identifikon autorët
22 Mars, 2024

Osman Mula: Jorgo Papingji ishte një edukator i madh i brezave të rinj
22 Mars, 2024

Këngëtari Devis Xherahu përkujton Jorgo Papingjin: E kisha si baba pasi...Ja pengu i tij më i madh
22 Mars, 2024

"Nga platforma e madhe shkuam në një Nënkomision", Açka: Zgjedhorja dështoi. Pse nuk u ngritën 4 Komisione Hetimore?
22 Mars, 2024

Akuzat për korrupsion, SPAK nis hetimet për kryebashkiakun e Rrogozhinës, Edison Memolla. Po verifikohen edhe pasuritë
22 Mars, 2024

U përfol për një lidhje me Princin William, Rose Hanbury ngre padi kundër gazetarit
22 Mars, 2024

BW · Download on the App Store · GET IT ON Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

VIDEO trondítëse në Korçë/ Katër të rinj rrahin barbarisht me shkopinj 30-vjeçarin në servisin e automjetève. Policia identifikon autorët
22 Mars, 2024

Osman Mula: Jorgo Papingji ishte një edukator i madh i brezave të rinj
22 Mars, 2024

Këngëtari Devis Xherahu përkujton Jorgo Papingjin: E kisha si baba pasi...Ja pengu i tij më i madh
22 Mars, 2024

"Nga platforma e madhe shkuam në një Nënkomision", Açka: Zgjedhorja dështoi. Pse nuk u ngritën 4 Komisione Hetimore?
22 Mars, 2024

Akuzat për korrupsion, SPAK nis hetimet për kryebashkiakun e Rrogozhinës, Edison Memolla. Po verifikohen edhe pasuritë
22 Mars, 2024

U përfol për një lidhje me Princin William, Rose Hanbury ngre padi kundër gazetarit
22 Mars, 2024

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.